

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 173/2014 “PËR DISIPLINËN NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është dhënia e të drejtës për të patur ndihmës në proces gjyqësor për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte, i cili e ndihmon atë në çështje specifike, të nevojshme për procedimin disiplinor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, brenda katërmujorit të dytë të vitit 2022, për Ministrinë e Mbrojtjes, në zbatim të vendimit nr. 850, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky ndryshim në projektligj është i nevojshëm pasi i garanton palës të paraqitet në seancë dëgjimore e shoqëruar nga një ndihmës, i cili e ndihmon atë në çështje specifike, të nevojshme për procedimin disiplinor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje të plotë me rendin juridik të brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Projektligji nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji pëson ndryshime në një pikë, konkretisht:

Pika 1 e projektligjit parashikon ndryshimin në pikën 3 të nenit 17, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar bëhet:

Të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të parashtruar prova e fakte ushtaraku e ushtron personalisht ose i shoqëruar nga një ndihmës, i cili e ndihmon atë në çështje specifike, të nevojshme për procedimin disiplinor.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Me zbatimin e këtij projektligji do të ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky projektligj është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë nëpërmjet shkresës zyrtare, protokolluar pranë Ministrisë së Mbrojtjes me nr.3407/3 datë 5.08.2022, ka shprehur komente dhe sugjerime mbi ligjshmërinë e formës dhe përmbajtjes, të cilat u morën parasysh dhe u reflektuan në projektligj.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky projektligj nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi

Konceptoi: A. Reçi
Pranoi: A. Çollaku
Konfirmoi: G. Prodani
1K/datë: 21.09.2022

Relacion shpjegues për projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.